



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kms hc.al



www.kms hc.al

25 Tetor 2024

# NJOFTIM

## TAKIM PUNE MBI APLIKIMIN E SKEMËS PËR SHËRBIMIN CIVIL NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Në datat 22-24 Tetor 2024, në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil u organizuan disa takime pune me Sekretarët e Përgjithshëm dhe përfaqësues të njësive përgjegjëse të njësive të qeverisjes vendore (61 bashki), për të diskutuar në lidhje me aplikimin e skemës së shërbimit civil në këtë tipologji institucionesh.

Këto takime ishin në vazhdim të procesit të unifikimit të strukturave në njësitë e qeverisjes vendore, një iniciativë që Komisioneri e ka nisur prej më shumë se tre vitesh.



Për shkak të rolit mbështetës, në këto takime morën pjesë edhe përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Administratës Vendore, nga ana e së cilës janë hartuar disa manuale orientuese me synimin për të kontribuar në përmirësimin e situatës në administratën vendore duke siguruar administrimin e burimeve njerëzore me efikasitet dhe efektivitet.

Gjatë takimeve u diskutua edhe rëndësia e zbatimit të akteve nënligjore që përcaktojnë strukturën e shërbimit civil dhe kategoritë përkatëse. Komisioneri theksoi se aplikimi praktik i këtyre kërkesave është një nga sfidat më të mëdha të këtij procesi, duke sjellë në vëmendjen e pjesëmarrësve disa momente kyçe që kërkojnë kujdes të veçantë, të tilla si:

1. Vlerësimi i pozicioneve të punës: Përcaktimi përfundimtar i listës së pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil.
2. Trajtimi i punonjësve: Rregullimi i situatës për ata punonjës që do të preken nga rivlerësimi dhe ristrukturimi, duke u siguruar që të kenë dëmshpërblim sipas vjetërsisë në punë në rastet e lirimit.
3. Zgjidhja e problemeve ligjore: Adresimi i situatave të punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin, të cilët nuk mund të sistemohen në pozicione të shërbimit civil pas procesit të ristrukturimit.

Gjatë këtyre takimeve, u diskutuan një pjesë e mirë e problematikave që kanë hasur këto njësi. Ky proces do të vijojë nëpërmjet mbështetjes teknike që Komisioneri do të ofrojë për këto institucione nëpërmjet vizitave në subjekt, për të monitoruar nga afër ecurinë e tij.

Në përfundim të takimit, nga ana e Komisionerit u kërkuar rritja e nivelit të bashkëpunimit me qëllim që të realizojmë një punë efikase dhe të shmangim shpenzimet e panevojshme të energjisë.

